

VENDIM
Nr.69, datë 9.8.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DITEKO” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET NË LUMIN “ZALLI I OKSHTUNIT”: “BOROVË”, “ZABZUN”, “SEBISHT”, “PRODAN 1”, “PRODAN 2”, “OKSHTUN EKOLOGJIK”, “TERNOVË”, “OKSHTUN”, “LUBALESH 1”, “LUBALESH 2” DHE “GJORICË”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13, pika 1 germa “a”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.8.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Diteko” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Diteko” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit për licencimin e shoqërisë “Diteko” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et në lumin “Zalli i Okshtunit”: “Borovë”, “Zabzun”, “Sebisht”, “Prodan 1”, “Prodan 2”, “Okshtun ekologjik”, “Ternovë”, “Okshtun”, “Lubalesh 1”, “Lubalesh 2” dhe “Gjoricë”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani